



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BUJQËSISË
ZHVILLIMIT RURAL DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE
KËSHILLI I BASENIT UJOR “VJOSË”

VENDIM

Nr. 9 Data 04.08.2017

Për miratimin në parim të kërkesës, për shfrytëzim të burimit ujqor në përroin e Mezqhoranit, dega e lumit Vjosë, për ndërtimin e hidrocentralit "Bregu i Lerës" për prodhim të energjisë elektrike, Rrethi Tepelenë, qarku Gjirokastër, subjektit "INVICTUS" sh.p.k., me administrator Znj. Laerta Liko .

Në bazë të ligjit **Nr.111/2012 datë 15.11.2012** "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", të **V.K.M 416 datë 13.05.2015** "Për miratimin e kushteve të përgjithshme e të posaçme, dokumenteve shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularëve të aplikimit për autorizim dhe leje, procedurave të shqyrtimit e vendimmarrjes dhe formateve të autorizimit e lejes për përdorim të burimeve ujore", formulari D, dokumentacioni teknik, Vendimit **Nr. 876, datë 14.12.2016** "Për miratimin e tarifave të shpenzimeve administrative" si dhe Vendimit **Nr. 662 datë 21.09.2016** "Miratimin e tarifave të përdorimit të ujit dhe të shkarkimeve të lëngëta ",Vendimit **Nr.5 datë 16.02.2016**, Për miratimin e rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Basenit Ujqor", Vendimit **Nr.6 datë 16.02.2016**, Për miratimin e rregullores "Për funksionimin e Agjensisë së Basenit Ujqor"; V.K.M Nr.822, datë 07.10.2015, "Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni", shkresës zyrtare të Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar të Ujit, **Nr. 526, datë 21.10.2016 "Vënie në dijeni"**,

VENDOSI

Miratimin në parim të kërkesës, për shfrytëzim të burimit ujqor në përroin e Mezqhoranit, dega e lumit Vjosë, për ndërtimin e hidrocentralit "Bregu i Lerës" për prodhim të energjisë elektrike, Rrethi Tepelenë, qarku Gjirokastër. subjektit "INVICTUS" sh.p.k., me administrator Znj. Laerta Liko me këto të dhëna:

Koordinatat: X4423371; Y4465581; Z 615.00

Prurja mesatare: 0.415 m3/sek

Prurja e llogaritur: 0.552 m3/sek

Prurja e ekologjike: 0.038 m3/sek



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BUJQËSISË
ZHVILLIMIT RURAL DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE
KËSHILLI I BASENIT UJOR “VJOSË”

Fuqia e instaluar e hidrocentrali llogaritet të jetë **1995 kW**

Për përdorimin e këtij burimi ujor duhen të plotësohen me përpikmëri kushtet e lejes.

Ngarkohet ABU për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

PËRGJEGJËS I A.B.U “VJOSË”

Ilir PROEKA



KRYETAR I K.B.U “VJOSË”

Etjona HOXHA

